



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1309 prot.

Tiranë, më 08. 07. 2026

V E N D I M

Nr. 183, datë 08. 07. 2026

Bazuar në pikën 11¹, të nenit 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O N:

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit administrativ, për të shqyrtuar ankesën nr. 224, datë 08.10.2025, të R. S., kundër Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, me pretendimin për diskriminim, për “*çdo shkak tjetër*”³.

Bazuar në Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri ka dalë me Vendimin Nr. 65, datë 31.03.2026, me anë të të cilit, ka vendosur:

1. *Konstatimin e diskriminimit të ankueses R. S., në të drejtën për punësim, në formën e viktimizimit dhe në formën e shqetësimit, nga ana e Bibliotekës Kombëtare.*
2. *Biblioteka Kombëtare, të marrë masa për të parashikuar në rregulloret dhe aktet e saj të brendshme, procedura konkrete për trajtimin e ankesave për diskriminim sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe të*

¹ “Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”.

² Në vijim do t’i referohemi si Komisioneri ose me akronimin KMD.

³ Ka referuar se shkak është bërë debati mes saj dhe Përgjegjësit të Sektorit, për mosfirmosjen e një procedure prokurimi.

marrë masa për trajnimin e organeve përgjegjëse për trajtimin e ankimeve me objekt diskriminimin.

3. *Biblioteka Kombëtare, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.*

Në zbatim të vendimit të sipërcituar, me shkresën nr. 398/1 prot., datë 21.04.2026, Biblioteka Kombëtare informoi Komisionerin lidhur me angazhimin për marrjen e masave për njohjen dhe zbatim të vendimit sipërcituar. Njëkohësisht, për marrjen e masave të nevojshme administrative mbi trajtimin e ankesave për diskriminim, duke i parashikuar në rregulloren e brendshme.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresën nr. 1092 prot., datë 10.06.2026, drejtuar Bibliotekës Kombëtare, i kujtoi dërgimin e informacionit për zbatimin e vendimit, sa i përket rishikimit të Rregullores së Brendshme të institucionit, ku parashikohej procedura e shqyrtimit të ankesave për diskriminim.

Në zbatim të vendimit të Komisionerit, Biblioteka Kombëtare, me shkresën nr. 398/3, datë 17.06.2026, ka dërguar “*Rregulloren mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë*”, të ndryshuar, datë 05.02.2026.

Në shqyrtimi i dokumentit sipërcituar, Komisioneri vlerëson se Biblioteka Kombëtare, nuk ka zbatuar vendimin e Komisionerit, duke mos bërë parashikimet në rregulloren e brendshme të institucionit sa i përket parashikimit në të, të procedurave të shqyrtimit të ankesave për diskriminim.

Sa më sipër, rezultoi e provuar se, Biblioteka Kombëtare, në cilësinë e subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, nuk ka marrë masa për zbatimin e Vendimit Nr. 65, datë 31.03.2026, të Komisionerit. Në këtë mënyrë, Biblioteka Kombëtare nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga nenin 33, pika 11, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33, pika 11, të ligjit të sipërpërmendur, shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat juridik, siç është në rastin konkret Biblioteka Kombëtare, në nenin 33 pika 13 të ligjit 10221/2010 parashikohet se : “*Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë*”:.....
b) *personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;.....*”

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Biblioteka Kombëtare është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, shkelje e cila sipas parashikimeve të kësaj pike, është e dënueshme me gjobë.

Në lidhje me masën e gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të Ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku sanksionohet se: “*12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës.*

Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni”.

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës dhe bazuar në faktin që, Biblioteka Kombëtare nuk është përsëritëse në konsumimin e shkeljeve të së njëjtës natyrë: Komisioneri, arrin në përfundimin se, Biblioteka Kombëtare duhet të gjobitet me 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për moszbatimin e Vendimit Nr. 65, datë 31.03.2026, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32/1, shkronja “ç”, neni 33, pikat 11, 12, 13/b dhe 14, si dhe nenin 33/1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Biblioteka Kombëtare, të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për moszbatimin e Vendimit Nr. 65, datë 31.03.2026, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.
3. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi i institucionit përfitues: 1091001, Kodi i Degës së Thesarit: 3535, Kodi i llogarisë ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i Vendimit Nr. 65, datë 31.03.2026, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tij.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)